

STATUT

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR: "10AE" shpk, TIRANË

në referim të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
ndryshuar me ligjin 129 datë 02.10.2014 dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për
Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar

KREU I

TË DHËNAT E SHOQËRISË TREGTARE

Neni 1 – emri i shoqërisë

"10AE"

shqiptimi: dhjetë AE

Neni 2 – forma

shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk)

Neni 3 – data e themelimit

14 DHJETOR 2018

Neni 4 – kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar

Neni 5 – kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100'000 lekë (njëqind mijë).

Neni 6 – themelues

ELVIRA LAME, e bija e Demirit dhe Manushaqes, dt. 14.12.1966, lindur e
banuese në Tiranë.

Neni 7 – objekti

7.1 Punime inxhinierike në projektim e zbatim

7.2 Projektim në rilevime inxhinierike në të gjitha shkallët / rilevime
inxhinierike kadastrale në të gjitha shkallët / sisteme GIS / bazamente
gjeodezike / projektim fotogrametrik / hartografik / përgatitje
planimetri / planvendosje / genplane / plane rilevimi
gjeoreferime / përgatitje ortofoto


7.3 Punime zbatimi topogjeodezike

7.4 Kolaudim punimesh zbatimi

7.5 Mbikqyerje punimesh zbatimi

7.6 Vlerësime të Pasurive të Paluajtshme të llojit: tokë truall / ndërtesa /
tokë bujqësore / tokë pyll / tokë kullotë / tokë livadh / tokë të pafrytshme

7.7 Përgatitje Ekspertiza Teknike / Raporte Vlerësimi



- 7.8** Konsulencë: inxhinierike / punë sociale / juridike / kontabël / mjedisi
7.9 Shërbim në fushën e Avokatisë
7.10 Ndërmjetësime (broker) / shërbime në shit-blerje, dhënie-marrje me qira pasuri të paluajtshme (real-estate, imobiliare)
7.11 Fashion / stilime / fasoneri
7.12 Interior design
7.13 Guida turistike
7.14 Eksporte / importe
7.15 Tregti: me pakicë / shumicë / E-commerce

Neni 8 – selia

- 8.1** adresa: Rruga "Et'hem Haxhiademi", shtesë e pall. 27/2, nr. 1, Tiranë
8.2 nr. kontakti: +355 676060077
8.3 E-mail: 10aehq@gmail.com

Neni 9 – zotërimi i kapitalit të shoqërisë

Ortaku i vetëm themeues ELVIRA D. LAME zotëron 1 kuotë, e cila ka vlerën totale të kapitalit të shoqërisë: 100'000 lekë

Neni 10 – zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Zmadhimi, apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë bëhet në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 11 – transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit mund të fitohen, apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes
- c) trashëgimisë
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashitkuar me ligj

KREU II

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 12 – organi vendimarrës

Organi vendimarrës i shoqërisë "10AEL " shpk është:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, që përfaqësohet nga ortaku i vetëm, ELVIRA D. LAME.

Kjo Asamble e Përgjithshme e ushtron autoritetin e saj konform ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe mënyrës së përcaktuar në këtë STATUT.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë vendos për këto probleme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) Ndryshime në statut
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorit nëse është i ndryshëm nga ortaku
- ç) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe ç të këtij n/neni
- dh) Mbikqyerjen e zbatimit të politave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- i) miratimin e logos së shoqërisë
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

Neni 13 – mënyra e thirrjes së Asamblesësë Përgjithshme të Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, që përfaqësohet nga ortaku i vetëm, ELVIRA D. LAME, duhet të thirret minimalisht 2 herë në vit.

Neni 14 – administrimi e përgjegjësitë e administratorit

Administrator i shoqërisë është ortaku i vetëm i saj:

ELVIRA LAME, e bija e Demirit dhe Manushaqes, dt. 14.12.1966, lindur e banuese në Tiranë.

14.1 Të drejtat e detyrimet e administratorit janë të përcaktuara në nenin 95, pika 3 e vijues të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë

Elvira Lame
3.

- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, raportin vjetor të ecurisë së veprimtarisë, propozon shpërndarjen e fitimit, etj të cilat ia paraqet për mitatim asamblesë se përgjithshme
- e) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për QKB (QKR)
- f) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë
- g) hap llogari bankare në emër të shoqërisë, dhe kryen të gjitha veprimet bankare
- h) kryen detyrat e përcaktuara në ligj

14.2 Administratori i shoqërisë është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë, ose ndaj të tretëve, si dhe detyrohet të zbatojë detyrat e përcaktuara në nenet 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare".

14.3 Administratori ka të drejtë të lidhë kontrata qiramarrje nëse nevojiten ambiente shtesë për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë. Kohëzgjatja e kontratave të qirasë mund të jenë për një periudhë një, apo më shumë vjeçare. Këto kontrata të qiramarrjeve me të tretët do të miratohen vetëm me vendim me shkrim nga asambleja e përgjithshme e ortakëve të shoqërisë, në të kundërt do të konsiderohen të pa ligjshme.

KREU III

VITI FINANCIAR / EKSPERTËT / PUNËSIMET

Neni 15 – viti financiar i shoqërisë

Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor.

Neni 16 – veprimet financiare të shoqërisë

Veprimet financiare të shoqërisë do të mbyllen në datë 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në fund të çdo periudhe financiare eksperti i emëruar nga asambleja e ortakëve, nxjerr bilancin kontabël të shoqërisë, si dhe rezultatin ekonomik të fitimit, apo humbjet sipas ligjeve e rregullave financiare në fuqi. Llogaritjet vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme. Bilancet e shoqërisë do të paraqiten përpara ortakëve të shoqërisë deri në fund të muajit Shkurt të vitit pasardhës kalendarik dhe asambleja do t'i miratojë brenda datës 15 Mars të atij viti. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 muajve të vitit pasardhës nga data e mbylljes së vitit financiar, duke u respektuar procedurat e përcaktuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Handwritten signature and date:
14.12.2018

Neni 17 – ekspertët

Ekspertët e emëruar nga administratori ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, gjithëvjetor, apo periodik, sipas përcaktimeve që do kërkohen nga ortaku i shoqërisë Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjeb e rezultatit të bilancit financiar vjetor, apo periodik, të cilat është i detyruar t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut, për t'i shqyrtuar e miratuar me bazën e te drejtës vendimore që ka.

Neni 18 – të punësuarit

Marrëdhëniet e shoqërisë me të punësuarit (në rast se do të ketë), rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk rregullohen me kontratë zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar për të punësuarit në Republikën e Shqipërisë dhe për të punësuarit nëpër filiale jashtë territorit shqiptar, zbatohen dispozitat e legjislacionit të vendeve përkatëse.

18.1 Organograma, kandidaturat për stafin dhe kontrata TIP e punës për çdo vit ushtrimor financiar do të miratohen nga asambleja e përgjithshme e ortakëve. Kontrata e Punës për stafin e miratuar nga asambleja e përgjithshme e ortakëve do të lidhet e nënshkruahet nga administratori më vete për secilin punonjës të shoqërisë

18.2 Ortaku, që është dhe administratori do të vlerësojnë mundësinë e përshtatjes së pagave dhe të vendeve të punës sipas mundësive financiare të shoqërisë, deri në diskutim për ndryshimin e niveleve të tyre (pagave), ose masa të tjera që mund të jenë të detyrueshme për shkak të situatës ekonomike-financiare të shoqërisë. Kjo do të bëhet përpara miratimit të stafit dhe kontratave të punës, dhe në varësi të vlerësimeve ekonomike.

18.3 Kontratat e punës do të lidhen në afat jo më të gjatë se 1 vit.

18.4 Për punë sezonale, kohëzgjatja e punëmarrësve mund të jetë dhe disa ditore / javore/ apo me kohë të pjesshme, pra më pak se 40 orë/javë.

KREU IV

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 19 – prishja dhe likuidimi

Shpërndarja, ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) me vendim të Asamblesë së Ortakëve
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit
- c) në rast se nuk ka veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.

9723 datë 03.05.2007, ndryshuar.

- d) me vendim Gjykate

Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Neni 20 – riorganizimi i shoqërisë, bashkimi / ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë të Ortakëve.

KREU V
TË NDRYSHME

Shoqëria si person juridik privat, e fiton zotësinë për të vepruar pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).


Shoqëria ka të drejta dhe detyrime për të cilat përgjigjet brenda kufijve të përcaktuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Përsa nuk është parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Statuti u hartua në gjuhën shqipe, në tre kopje origjinale, të cilat kanë të njejtën fuqi ligjore, dhe janë miratuar e nënshkruar nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në zbatim apo interpretim të këtij STATUTI, si dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjyqësori Shqiptar.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "10AEL" shpk

ELVIRA D. LAME



p.s.

Shoqëria "10AE" shpk, mbart eksperiencën 15 vjeçare të personit fizik ELVIRA LAME, të regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 26044 datë 16.12.2003 (identifikuar: K41406009P & L61423003J).